

VENDIM
Nr. 504, datë 1.8.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1135, DATË 5.8.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 88 të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të nenit 32 të Rregullores së Personelit të Policisë së Shtetit, miratuar me vendimin nr. 804, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1135, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, lidhja nr. 1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. “Specialistët”, “përgjegjësit e sektorit” apo “drejtorët” në Policinë e Shtetit, të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së Policisë së Shtetit dhe kërkojnë në mënyrë të detyrueshme diplomë universitare “Master i shkencave” apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë “për kushte pune” prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh, mbi pagën mujore të gradës përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak nga Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Financave, sipas përshkrimit të pozicioneve të punës.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave për vitin 2012.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 15 korrik 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha